



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**  
**REKTORATI**  
[www.uamd.edu.al](http://www.uamd.edu.al)

---

**N J O F T I M**

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, shpall konkursin për një vend të ri pune për personel akademik me kohë të plotë në Filialin e Peshkopisë, sipas specialitetit të mëposhtëm:

**1. Specialiteti Ekonomik 1 (një) vend**

- A. Të interesuarit për vendet e mësipërme duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtëme:
1. Të ketë mbaruar studimet e larta në degën ekonomik me mesatare mbi 8.
  2. Të ketë mbaruar Master Shkencor në specialitetin përkatës. Preferohen kandidatët që kanë gradën Doktor.
  3. Të jetë i aftë të garantojë vlerësimin, efikasitetin dhe ekselencën e lëndëve që do të japë.
  4. Të ketë njohuri mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor.
  5. Të njohë dhe të jetë familjar me sistemin e funksionimit të universiteteve perëndimore dhe të Kartës së Bolonjës.
- B. Të interesuarit duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Formularin e aplikimit për personel akademik i cili mund të shkarkohet në faqen e internetit të universitetit në adresën [www.uamd.edu.al](http://www.uamd.edu.al), ose të tërhiqet dorazi në zyrën e Degës së Burimeve Njerëzore të universitetit;
  2. Tre letra rekomandimi nga pedagogë apo udhëheqës shkencor të kandidatit dhe të paktën një nga tre letrat të jetë nga punëdhënësi / drejtuesi i fundit nëse ka një të tillë;
  3. Fotokopje të diplomës, të noterizuar;
  4. Fotokopje të çertifikatës së notave të noterizuar;
  5. Fotokopje të dëshmimeve kualifikimi të ndryshme, të noterizuara;
  6. Fotokopje të artikujve shkencorë të publikuar në revista ndërkombëtare profesionale / shkencore dhe / ose punime të tjera;
  7. Fotokopje të pasaportës ose të një dokumenti identifikimi;
  8. Të përgatisë një orë leksioni të hapur.
  9. Deklaratë nga kandidati aplikues për gjëndjen gjyqësore.

*Diplomat, çertifikatat, gradat dhe titujt e fituar në institucione të huaja arsimore, duhet të jenë të përkthyer dhe të shoqërohen me çertifikatën e njehsimit, bazuar në Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38.*

C. **Afati i fundit i pritjes aplikimeve është deri në 31 Dhjetor 2011.**

D. Të interesuarit duhet të dërgojnë me postë dokumentacionin përkatës, në adresën;

**Universiteti “Aleksandër Mosiu”**  
**Për Filialin e Peshkopisë**  
**Specialiteti: \_\_\_\_\_**  
**Lagja 1, Rruga e Currilave, Durrës.**

- E. *Nuk lejohet paraqitja e dokumentacionit dorazi.*
- F. *Proçedura e përzgjedhjes së kandidaturave fillon menjëherë pas publikimit të këtij njoftimi dhe do të zhvillohet sipas Udhëzimit Nr. 129, datë 30.01.2009 “Për përzgjedhjen dhe rekrutimin e personelit akademik, ndihmës mësimor – shkencor dhe administrativ, në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës.*